



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 356 Prot

Tiranë, më 27, 11, 2014

VENDIM Nr. 356, datë 17.11.2014

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 17.11.2014, pasi shqyrtoi kërkesën për "Zbatimin në faza të projektit të gjurmimit shpëtimor të By-Passit, Levan-Fier, pas kryerjes së plotë të këtyre punimeve në sektorin A1, A2 dhe pjesërisht në sektorin A, paraqitur nga subjekti i licensuar "Ad Star",

VENDOSI:

- I. Të miratojë kërkesën për "Zbatimin në faza të projektit të gjurmimit shpëtimor të By-Passit Levan-Fier, mbulimin e kuadrateve të gjurmimit arkeologjik në Sektorët A1, A2 dhe pjesërisht në Sektorin A, spostimin e rrugës së kantierit mbi kuadratet e mbuluara, që të mundësohet vazhdimi i punimeve të gjurmimit shpëtimor në kuadratet e mbetura 31, 33 dhe 34 të Sektorit A dhe fillimi i punimeve në Sektorin B, të By-Passit të Levan-Fier.
- II. Gjetjet arkeologjike të depozitohen pranë Qendrës së Studimeve Albanologjike, në Apoloni dhe një listë e inventarit të tyre të dorëzohet pranë Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik të Apolonisë.
- III. Gjatë zbatimit të punimeve të realizohet mbikqyrja arkeologjike periodike nga arkeologët e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik, sipas kontratës trepalëshe me ASHA, rregullores së KKA dhe në përputhje me konceptin e gjurmimit të shpëtimor arkeologjik të miratuar.
- IV. Në zbatim të këtij vendimi, subjekti duhet të depozitojë pranë ASHA planvendosjet sa i takon spostimit të rrugës së kantierit (material grafik plotësues), që mundëson vazhdimin e punimeve të gjurmimit shpëtimor në kuadratet e mbetura 31, 33 dhe 34 të Sektorit A, si dhe fillimit të punimeve në Sektorin B, të By-Passit Levan-Fier.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**

**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**

**RUDINA ZOTO**